



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet:

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

dhe

GRUPIT PËR STUDIME JURIDIKE DHE POLITIKE (*GLPS*)

për implementimin e projektit të titulluar:

"BOOSTING EFFICIENCY: Monitoring and assessing the implementation of rule of law principles' in Kosovo on the basis of the Council of Europe Rule of Law Checklist" (shqip: 'RRITJA E EFIKASITETIT: Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të parimeve të sundimit të ligjit në Kosovë në bazë të Listës së Kontrollit të Sundimit të Ligjit të Këshillit të Evropës")

Financuar nga: Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë – Programi MATRA

Gusht 2021

Neni 1 [Fushëveprimi]

Ky Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës (tutje: Kuvendi) dhe GLPS-së lidhet me qëllim të mundësimit të zbatimit të projektit të titulluar: "BOOSTING EFFICIENCY: Monitoring and assessing the implementation of rule of law principles' in Kosovo on the basis of the Council of Europe Rule of Law Checklist" (shqip: 'RRITJA E EFIKASITETIT: Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të parimeve të sundimit të ligjit në Kosovë në bazë të Listës së Kontrollit të Sundimit të Ligjit të Këshillit të Evropës"), financuar nga: Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë – Programi MATRA dhe zbatuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (nr. i regjistrimit 5110959-7). Qëllimi i këtij Memorandumi është që të përcaktoj veprimet e përbashkëta ndërmjet Kuvendit dhe GLPS-së sa i përket implementimit të këtij projekti.

Neni 2 [Qëllimi i Memorandumit]

Qëllimi i këtij Memorandumi është që të përcaktoj veprimet e përbashkëta ndërmjet Kuvendit dhe GLPS-së, sa i përket implementimit të këtij projekti si dhe përgjegjësitë e secilës palë, me synim final të dhënies së qasjes së plotë në të dhëna publike, të nevojshme për zbatimin e projektit, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. Kërkesa dhe qasja në dokumente të klasifikuara, bëhet në përputhje me ligjin përkatës për klasifikimin e informacionit.

Neni 3 [Obligimet e Kuvendit]

1. Me qëllim të zbatimit të këtij Memorandumi, Kuvendi do të marr përsipër këto obligime:

- Në bazë të përgjegjësisë që e ka, t'i jap qasje të plotë GLPS-së në të dhëna publike sipas legjislacionit përkatës në fuqi, të nevojshme për zbatimin e projektit në fjalë, atëherë kur kërkohen nga stafi zyrtar i projektit;
- Kuvendi merr përsipër që t'i njoftoj të gjitha njësitë e tij në lidhje me këtë memorandum, dhe t'u kërkoj atyre që të ofrojnë të dhëna publike, në rast nevojë, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;
- Kuvendi nuk merr përsipër asnjë detyrim financiar, apo çfarëdo lloji tjetër të shpenzimit në raport me projektin.

Neni 4 [Obligimet e GLPS-së]

1. Me qëllim të zbatimit të këtij Memorandumi, GLPS do të marr përsipër këto obligime:

- Të menaxhoj në tërësi me projektin në fjalë;
- Të dhënat e marra nga Kuvendi të përdoren vetëm për qëllim të implementimit të këtij projekti, më konkretisht, për qëllime hulumtimi dhe monitorimi;
- GLPS nuk mund të shfrytëzoj këtë Memorandum Bashkëpunimi për asgjë tjetër, përveç për zbatimin e projektit në fjalë.

Neni 5 [Kohëzgjatja]

Ky Memorandum do të zgjatë dy (2) vite, nga dita e nënshkrimit nga palët nënshkruese deri në përfundim të projektit.

Neni 6 [Zgjidhja e mosmarrëveshjes]

Palët nënshkruese të këtij Memorandumi pajtohen që me mirëkuptim, konsultime dhe negociata t'i zgjidhin të gjitha çështjet kontestuese të cilat mund të lindin gjatë zbatimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit.

Neni 7 [Interpretimi]

Ky Memorandum Bashkëpunimi është i punuar në tri (3) gjuhë: shqipe, angleze dhe serbe. Në rast konflikti në mes teksteve, do të mbizotëroj versioni në gjuhën shqipe.

Neni 8 [Ndërprerja]

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndërpritet në çdo kohë nga cilado palë, me paralajmërim me shkrim së paku tridhjetë (30) ditë para datës së ndërprerjes. Shkëputja e këtij Memorandumi mund të bëhet në mënyrë të njëanshme, në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të parapara në këtë Memorandum.

Neni 9 [Ekzemplarët e Memorandumit]


Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet në dy ekzemplarë të njëjtë, nga një ekzemplarë për secilën palë.

Neni 10 [Hyrja në fuqi]

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.


Palët Nënshkruese

Për Kuvendin:



Glauk Konjufca
Kryetar i Kuvendit
(vula)

Për GLPS:



Arbëresha Loxha Stublla
Drejtoreshë Ekzekutive, GLPS
(vula)

Data dhe Vendi: _____

